**VENDIM**
**Nr. 338, datë 22.4.2015**

# PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 253,DATË 6.3.2013, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE,"PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE TË PLOTËSIMITTË AKTEVE TË MARRJES SË TOKËS BUJQËSORENË PRONËSI PËR FAMILJET BUJQËSORE NË FSHATRATËISH-KOOPERATIVAVE BUJQËSORE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 16, të ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008, "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 253, datë 6.3.2013, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë vijon:

1. Kudo në vendim:

a) emërtimi "...Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit..." zëvendësohet me emërtimin "…Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave ...";

b) fjalët "…komuna/bashkia..." zëvendë-sohen me fjalët "...njësia e qeverisjes vendore ...";

2. Në pikën 10 shtohet shkronja "ç", me këtë përmbajtje:

"ç) Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave të përcaktojë, për të gjitha ngastrat e tokës bujqësore, të paraqitura në materialin hartografik, nëse janë në fondin e kompensimit fizik në dispozicion të kësaj agjencie."

3. Në pikën 15 shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

"Prefekti i qarkut duhet të shprehet mbi rregullshmërinë ligjore të çdo vendimi të marrë nga këshilli i njësisë së qeverisjes vendore në periudhën 1 janar 2014 deri në datën e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 172/2014, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9948, datë 7.7.2008, "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", të ndryshuar.".

4. Në pikën 16 shtohet shkronja "ç", si më poshtë vijon:

"ç) Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave.".

5. Në pikën 30, emërtimi "...Ministri për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit..." hiqet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Edi Rama**